

Specialist/Sektori i Certifikimeve dhe Konformitetit, Drejtoria e Certifikimit, Politikave e Legjislacionit të Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Në zbatim të ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar, ligjit nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 141 datë 22.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 763, datë 12.12.2022 “Për caktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së AKCESK”, i ndryshuar, urdhrin të Kryeministrit nr. 36, datë 19.02.2024 “Për disa ndryshime në urdhrin 233, datë 20.12.2023 ‘Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist/Sektori i Certifikimeve dhe Konformitetit, Drejtoria e Certifikimit, Politikave e Legjislacionit të Sigurisë Kibernetike**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

- Kryen detyrat në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, sipas përshkrimit të vendit të punës dhe është përgjegjës për punën që i ngarkohet;
- Zbaton të gjitha detyrat e caktuara nga eprori dhe argumenton punën profesionale që ka kryer;
- Kontrollon dokumentacionin e subjekteve të ndryshme, të cilat paraqesin kërkesën e tyre për regjistrim si Ofrues të Kualifikuar të Shërbimit të Besuar pranë Autoritetit, ku në përfundim harton raportin përkatës të nënshkruar.
- Kontrollon dokumentacionin e subjekteve të ndryshme, të cilat paraqesin kërkesën e tyre për regjistrim si Organizma Testimi dhe Konfirmimi pranë Autoritetit, ku në përfundim harton raportin përkatës;
- Merr pjesë në seminare, konferenca kombëtare apo ndërkombëtare, ku caktohet nga eproret duke përfaqësuar Autoritetin.
- Verifikon dokumentacionin si dhe ndjek procedurat mbi proceset e lidhura me shërbimet e besuara;
- Analizon raportet e Organizmave të Testimit dhe Konfirmimit, mbi kontrollin Ofruesve të Kualifikuar të Shërbimeve të Besuara të përcjella në Autoritet. Harton informacion të përmbledhur mbi gjetjet e evidentuara dhe konkluzionet e ketyre raporteve;
- Harton listat e besuara, të OKSHB -ve që kanë filluar aktivitetin, si dhe OKSHB-ve që kanë përfunduar aktivitetin.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Arsimi: Niveli minimal i diplomës “Master Profesional”, në Teknologji Informacioni/ Inxhinieri Kompjuterike/ Inxhinieri Informatike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Shkenca Kompjuterike/ Informatikë Ekonomike/ Shkenca Juridike.

Përvoja: Të paktën 1 vit përvojë pune në profesion.

FUSHA E NJOHURIVE:

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Ligji nr. 9880, datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 2/2017 “Për Sigurinë Kibernetike”;
- Specialitetet brenda fushës së caktuar profesionale.
- Ligji nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar.

Aftësi për të:

- Integruar informacionin me politikat institucionale;
- Identifikuar dhe qartësuar çështje e dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale;
- Analizuar, komunikuar, prezantuar, si dhe për të pranuar metoda dhe procedura të reja;
- Të njohë mirë gjuhën angleze.

Çdo kandidat jo-kualifikues pas procesit të intervistës, ka të drejtë për ankim jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike pas marrjes së njoftimit.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KLASËN (IV-1)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 18.03.2024, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.